



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinorë
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës



Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2016



Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT TE KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY



Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Prishtinë, 2018

Të nderuar lexues,



Mbrojtja e mjedisit dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore vazhdon të mbetet një nga sfidat më të mëdha të shoqërisë sonë.

Nevojat për zhvillim ekonomik dhe kërkesat sociale në rritje, kanë shtuar edhe kërkesat për shfrytëzim të resurseve natyrore por edhe ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis përmes shkarkimit të ndotësve.

Prodhimi i energjisë, zhvillimi i transportit, industria prodhuese, zhvillimet në sektorin e bujqësisë janë disa nga presionet direkte në mjedisin tonë, që vazhdojnë të jenë në rritje.

Përkundër kësaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor vazhdon të mbetet e përkushtuar që në frymën e zhvillimit të qëndrueshëm të zbatojë kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Hartimi i legjislacionit mjedisor dhe zbatimi i tij, hartimi i strategjive, planeve dhe programeve mjedisore janë vetëm disa nga angazhimet tona të përditshme në kuadër të arritjes së objektivave për mbrojtjen e mjedisit.

Fuqizimi i sistemit për monitorimin e gjendjes së mjedisit, rritja e kontrollit në zbatimin e legjislacionit mjedisor si dhe aplikimi i procedurave dhe standardeve mjedisore përballë kërkesave për shfrytëzim të resurseve natyrore dhe zbatim të projekteve që vlerësohet të kenë ndikim në mjedis paraqesin sfida por edhe po japin rezultate të kënaqshme.

Investimet në mjedis të realizuara qoftë nëpërmjet buxhetit të Kosovës apo edhe përmes ndihmës së donatorëve me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit dhe përmirësimit të infrastrukturës mjedisore por edhe ngritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale mjedisore në të gjitha nivelet, na bëjnë të besojmë që jemi në rrugën e duhur që të realizojmë qëllimet tona.

Rezultate të pamohueshme janë arritur në të gjitha segmentet mjedisore si në menaxhimin e mbeturinave, në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, në menaxhimin e ujërave, në adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, me zbutjen e pasojave të tyre, në rehabilitimin e zonave të ndotura, në kontrollin e ndotjes industriale, në planifikimin hapësinor si dhe në bashkëpunimin regional dhe ndërkombëtarë.

Ne besojmë fuqishëm që përmes bashkëpunimit me qytetarë, institucionet qeveritare, komunat, donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile do të përmbushim synimin që Kosova të jetë një vend i zhvilluar me mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Dr.sc. Albena Reshitaj, Ministre e MMPH-së

Të nderuar lexues dhe bashkëpunëtorë,



Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka kënaqësinë të ndajë me ju Raportin Vjetor për Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2016.

Raporti është përgatitur në kuadër të aktiviteteve për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore që ka AMMK për raportim të rregullt për gjendjen e mjedisit.

Raporti përmban kryesisht të dhëna nga monitorimi i gjendjes së mjedisi por edhe të dhëna nga projekte, publikimi dhe dokumente tjera relevante për mjedisin.

Pjesë e raporti janë edhe të dhënat nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare që kanë përgjegjësi të caktuara në sektorin e mjedisit dhe që ofrojnë të dhëna nga ky sektor. Përgatitja e raportit është mbështetur edhe nga sektorët e tjerë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Me këtë rast në emër të AKMM, shpreh falënderim dhe mirënjohje të gjithë atyre që kontribuan në finalizimin e këtij dokumenti, qoftë përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme ose duke dhënë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Ne i vlerësojmë, çmojmë dhe mirëpresim të gjitha angazhimet, vërejtjet dhe sugjerimet e institucioneve, ekspertëve, OJQ-ve mjedisore dhe dashamirësve të mjedisit, të cilat do të na ndihmojnë gjatë hartimit të publikimeve të ardhshme, për ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së tyre.

Shpresojmë që ky raport do të jetë një kontribut modest, jo vetëm për informimin real për gjendjen e mjedisit në Kosovës por edhe një dokument që do ti shërbejë politikbërësve në zbatimin e politikave të qëndrueshme mjedisore dhe donatorëve në orientimin e projekteve të ardhshme.

Dr.sc. Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv i AMMK-së

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Procedura e aprovimit të Raportit



Me datën 09.10.2017, Drejtoria për Gjendjen e Mjedisit ka përfunduar Raportin dhe e ka dorëzuar në Zyrën e kryeshefit të AMMK-së, dhe ka kërkuar procedimin e tij për miratim në Kuvendin e Kosovës sikurse e parasheh neni 25 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

Me datën 18.10.2017, kryeshefi i AMMK-së, përmes Ministrit të MMPH-së, i ka drejtuar Qeverisë së Kosovës, propozimin për rend dite: Procedimi në Kuvendin e Kosovës i Raportit vector për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2016.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 03.11.2017, ka shqyrtuar si pikë të rendit të ditës Raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Republikën e Kosovës për vitin 2016, dhe ka marrë vendimin nr.07/12, përmes të cilit ka miratuar Raportin dhe ka kërkuar që i njëjti të procedohet në Kuvendin e Kosovës.

Me datën 19.01.2018, në Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ka shqyrtuar Raportin vjetor për gjendjen e mjedisit për vitin 2016, dhe e ka proceduar atë në Kuvendin e Kosovës.

Në seancën plenare të datën 15.03.2018, pas shqyrtimit të Raportit dhe pas debatit lidhur me raportin, Kuvendi i Kosovës ka marrë Vendimin nr. 06-V-089, për miratimin e Raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016.



Përmbajtja

- 1. Hyrje**
- 2. Gjendja e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm**
 - 2.1. Ajri
 - 2.2. Uji
 - 2.3. Toka
 - 2.4. Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura
 - 2.5. Mbeturinat
- 3. Mjedisi dhe shëndeti publik**
- 4. Gjendja mjedisore e zonave të rrezikuara**
 - 4.1. Zona e KEK-ut dhe ndikimi në mjedis
 - 4.2. Zona e NeëCoFeronikeli dhe ndikimi në mjedis
 - 4.3. Zona e Sharcem dhe ndikimi në mjedis
 - 4.4. Zonat tjera të rrezikuara.
- 5. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit**
 - 5.1. Niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve mjedisore
 - 5.2. Përafrimi i legjislacionit mjedisor kombëtar me Direktivat e BE-së
 - 5.3. Inspektimi dhe kontrolli i zbatimit të Ligjit
 - 5.4. Lejedhënia
 - 5.5. Investimet në mbrojtjen e mjedisit
- 6. Referencat**
- 7. Lista e shkurtesave, figurave dhe tabelave**
- 8. Shtojcat**

Hyrje

Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit¹. Sipas nenit 25, të këtij Ligji, Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i paraqet Kuvendit Raport për Gjendjen e Mjedisit. Raporti duhet të përmbajë të dhëna për:

- gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm,
- ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës,
- gjendjen e mjedisëve të rrezikuara,
- zbatimin e strategjisë së mjedisit dhe planit të veprimit,
- masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit,
- zhvillimin e institucioneve mjedisore dhe
- financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit është institucioni që harton këtë dokument.

Ky Raport vjetor paraqet gjendjen e mjedisit për vitin 2016, por edhe të dhëna të mëhershme zënë vend të konsiderueshëm me qëllim krahasimi.

Për hartimin e raporti, AMMK ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore që tani janë prezantuar në këtë raport. Këto të dhëna janë në formë teksti, tabelash, hartash dhe paraqitjesh grafike.

Prezantimi i gjendjes për disa sektorë mjedisor është më pak i mbuluar si pasojë e mungesës së të dhënave, mungesës së monitorimit, bazës ligjore të pamjaftueshme apo dhe dobësive tjera institucionale e menaxhuese.

Cilësia e këtij raporti, deri në një masë është edhe reflektim i cilësisë së monitorimit që zbatohet në shkallë vendi dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor. Këto dy sisteme mjedisore ende janë në fazën e ngritjes dhe organizimit andaj ende ka mungesë të dhënave të plota dhe të besueshme.

Qëllimi kryesorë këtij raporti, është, informimi për gjendjen e mjedisit në Kosovë mirëpo, të dhënat e tij janë një bazë e mirë që mundë të shërbejnë edhe për hartimin e politikave adekuate mjedisore dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis siç janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj.

¹ Ligji Nr. 03/L-025

1. Gjendja e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis me raportin e mëparshëm

1.1. Ajri

Cilësisë së ajrit në këtë raport pasqyron gjendjen për territorin e Kosovës duke u bazuar në matjet nga stacionet për monitorim kontinual të cilësisë së ajrit. Burim i të dhënave janë kryesisht raportet mujore, që prezantojnë të dhënat e regjistruara nga stacionet të cilat janë nën menaxhimin e IHMK.

Dy nga stacionet e vendosura në Prishtinë janë reprezentative për cilësinë e ajrit në sfondin urban (Rilindja) dhe në sfondin suburbane (IHMK), ndërsa 6 stacionet tjera të vendosura në Mitrovicë, Drenas, Pejë, Prizren, Hani i Elezit, Gjilan, janë reprezentative për cilësinë e ajrit në sfondin urban dhe stacioni i vendosur në Brezovicë është për sfondin rural. Ndërsa 3 stacione të sfondit industrial janë vendosur në zonën e KEK-ut (Dardhishtë, Palaj dhe Obiliq). (Tabela 1)

Tabela 1 . Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit

Nr.	Emërtimi i stacionit monitorues	Kodi i stac.	Lokacioni	Institucioni përgjegjës	Parametrat që maten	Tipi i zonës
1	IHMK	KS0101	IHMK, Prishti në	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO	Sfondi urban
2	Rilindja	KS0102	Oborri i Rilindjes, Prishtinë	IHMK	PM10, PM2.5, O ₃	Sfondi urban
3	Pejë	KS0305	Sh. fillore "Lidhja e Prizrenit"	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ , NO _x , O ₃ , CO	Sfondi urban
4	Prizren	KS0406	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ ,	Sfondi urban
5	Brezovicë	KS0507	Zona e skijimit	IHMK	PM10, PM2.5,	Sfondi urban
6	Hani i Elezit	KS0508	Sh. fillore "Ilaz Hallaqi"	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ , N O _x , O ₃ , CO	Sfondi urb./in.
7	Gjilan	KS0609	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ , N O _x , O ₃ , CO	Sfondi urban
8	Drenas	KS0103	Kuvendi Komunal	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ , NO _x , CO	Sfondi urban
9	Obiliq	KS0110	QMF	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ , N O _x , O ₃ , CO	Sfondi urban
10	Dardhishtë	KS0111	Shkolla fillore	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ , N O _x , O ₃ , CO	Sfondi industrial
11	Palaj	KS0112	Kosova Mont	IHMK	PM10, PM2.5, SO ₂ , N O _x , O ₃ , CO	Sfondi industrial
12	Mitrovicë	KS0204	Stacioni i meteorologjisë	IHMK	CO, O ₃ , PM10, PM2.5	Sfondi urban

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Raporti përfshin vlerat mesatare mujore nga rezultatet e sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit në stacionet e rrjetit nacional. Duhet të potencohet se nuk ka pasur të dhëna kontinue nga disa stacione monitoruese dhe kjo e vështirëson vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes së ajrit. Ky fakt dhe mangësi tjera nuk janë objekt i shqyrtimit të këtij raporti, kështu që janë analizuar të dhënat të cilat kanë qenë në dispozicion.

Normat e cilësisë së ajrit në bazë të së cilave është bërë vlerësimi janë të bazuara në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011, (Tabela 2).

Tabela 2. Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimi Administrativ Nr.02/2011.

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare) $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	30	Nuk parashihet
SO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore të maksimale 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m^3	10	Nuk parashihet
PM ₁₀	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	40	Nuk parashihet
PM _{2.5}	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	25	Nuk parashihet
O ₃	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	120	Nuk parashihet
	Pragu i informimit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	180	Nuk parashihet
	Pragu i alarmit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	240	Nuk parashihet

Vlerësimi i cilësisë së ajrit gjatë vitit 2016 bazuar në të dhënat nga IHMK

Vlerësimi përfshin vlerat mesatare mujore dhe të njëjtat krahasohen me Vlerat maksimale të Lejuara (VML) sipas U.A.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit.

Dioskidi i sulfurit (SO₂). Është gaz toksik me veti acidike, pangjyrë dhe erë të forte. Burimet kryesore prej nga prodhohet ky gaz janë kapacitetet energjetike dhe ngrohtoret, të cilat shfrytëzojnë si emergjent naftën dhe thëngjillin me cilësi të dobët e të cilat përbëjnë sulfur.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Janë të njohura efektet në zvogëlimin e volumit pulmonar, rritja e rezistencës së frymëmarrjes dhe simptome të tilla si pengesa në frymëmarrje, ngushtime në gjoks dhe zvogëlim të ritmit të frymëmarrjes. Mund të shkaktojë kokëdhimbje dhe irritime të hundës. Dioksidi i sulfurit është ndër shkaktari kryesor i të ashtuquajturave **shirat acidike**, të cilat përshpejtojnë korrozionin e objekteve të ndërtimit dhe acidifikimin e dheut, liqeneve dhe rrjedhave të lumenjve.

Nga të dhënat për matjen e përqendrimit të SO₂ (7 stacione monitoruse) nuk ka asnjë tejkalim të VML (Vlerës Maksimale të Lejuar) gjatë gjithë vitit 2016. (fig 1).




Figura 1: VML për SO₂ sipas stacioneve matës për vitin 2016

Monoksidi i karbonit (CO)- Është gaz shumë helmues dhe i djegshëm. Kryesisht është produkt i djegies jokomplete të karbonit në lëndët djegëse. Konsumimi i duhanit në objekte të banimit, në zyre, makina dhe restorante e rrit përqendrimit të monoksidit të karbonit.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Qëndrimi i zgjatur në mjedis ku është i pranishëm CO mund të zvogëlojë sasinë e oksigjenit për frymëmarrje deri në atë masë sa njeriu humb vetëdijen si shkak i mungesës së oksigjenit. Monoksidi i karbonit kontribuon në efektin në Gazrat Serrë dhe ngrohjen globale.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Gjatë vitit 2016 vetëm në stacionin matës në Obiliq janë regjistruar tejkalime të VML (nëntor), ku vlera e përqendrimit të CO kishte vlerë mesatare mujore **21.7 mg/m³**. (Fig.2)




Figura 2: VML për CO sipas stacioneve matëse për vitin 2016

Dioksidi i azotit (NO₂) (përfaqëson rreth 80% të NO_x). NO₂ është gaz toksik, i cili kryesisht vjen nga djegia në makina, ngrohtore dhe nga termocentralet.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Oksidet e azotit kanë efekte të theksuara në mushkri por edhe në organet tjera si në mëlçi dhe shpretkë. Në gjak ka aftësi për krijim të metahemoglobinës, e cila nuk lejon transportimin e oksigjenit. Gazrat nitroze në ajër mund të shndërrohen në shira acidike. Gjithashtu NO dhe NO₂ janë kontribuues në hollimin e shtresës së ozonit.

Gjatë viti 2016 kishte vetëm një tejkalim të VML dhe atë në stacionin monitorues në IHMK gjatë muajit janar, ku vlera mesatare mujore ka regjistruar vlerën **49.6 µg/m³** (Figura 3).




Figura 3: VML për NO₂ sipas stacioneve matëse për vitin 2016

Ozoni (O₃)- Është substancë me toksicitet të lartë e veti oksiduese të theksuara dhe njihet si ndotës i zakonshëm. Ozoni formohet në atmosfere nga reaksioni mes oksideve të azotit, hidrokarbureve dhe dritës së diellit. Shumë nga pajisjet elektrike, si për shembull, televizorët, fotokopjuesit dhe motorët elektrik (që shfrytëzojnë brushat), prodhojnë sasi të tilla të ozonit sa njeriu shumë lehtë mund t'i nuhas si aromë.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Ndikimet akute përfshijnë simptomat në sistemin respirator, ndryshime në funksionimin e sistemit pulmonar, rritje e ndjeshmërisë respirative dhe inflamacione respiratore. Ozoni dëmton bimësinë dhe pyjet (efekti i fotooksidimit), prishjen e pamjes së qyteteve, parqeve nacionale dhe hapësirat për rekreacion.

Gjatë vitit 2016 kishte tejkalime të VML në Prizren, me vlerë mesatare mujore 170 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ gjatë muajit Gusht; Hani i Elezit me vlerë mesatare mujore 123 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ e regjistruar gjatë muajit korrik, (Figura 4).




Figura 4: VML për Oozon sipas stacioneve matës për vitin 2016

Grimcat e pluhurit (PM₁₀ dhe PM_{2.5})- Këto dy lloje të grimcave nuk janë komponime të veçanta, por përqendrimi i masës së pluhurit të suspenduar në ajër që kanë diametër më të vogël se 10 μm (PM₁₀) ose diametër më të vogël se 2.5 μm (PM_{2.5}). Janë me rëndësi të veçantë, posaçërisht në lokalitetet me trafik të dendur kur këta parametra tejkalojnë pragjet e lejuara apo VML, për publikun dhe popullsinë.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis. Një numër i madh i studimeve tregojnë ndikime afatshkurtra në sistemin kardiovaskular, të cilat ndërlidhen me PM, ndërsa ndikime direkte në një numër të sulmeve në zemër janë argumentuar se shkaktohen nga prezenca e PM në ajër.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Efekte afatgjata konsiderohen grimcat e pluhurit PM, të cilat kanë përmbajtje toksikologjike e të cilat sulmojnë sistemin respirator dhe zvogëlim të imunitetit për shkak të depërtimit të PM në thellësi të mushkërive dhe në pjesët bronkiale.

Gjatë viti 2016 kishte tejkalime të VML si mesatare mujore: 5 muaj në Obiliq; 2 muaj në Gjilan, Prishtinë-IHMK 2 muaj, Prishtinë-Rilindje 1 muaj, Prizren 2 muaj dhe Hani i Elezit 2 muaj.




Figura 5: VML për PM10 sipas stacioneve matës për vitin 2016

Ditët me tejkalime të PM10 gjatë viti 2016

Sipas U.A 02/2011, për Normat e cilësisë së ajrit, gjatë një vitit kalendarik janë të lejuara 35 ditë.

Gjatë viti kalendarik 2016 kishte tejkalime në këto qendra monitoruese: Obiliq me 102 ditë me tejkalime; në Rilindje me 39 ditë tejkalime dhe në Gjilan me 36 ditë me tejkalime.

Fillimi i vitit 2016 dhe muajt e fundit, karakterizohej me situatë më të rënduar sa për shkak të paraqitjes së ndotjes së theksuar me SMOG, i cili ishte prezent edhe në shumë qytete e shtete të rajonit, Evropës dhe botës në përgjithësi. AMMK ka përcjellë të dhënat nga monitorimi i PM2.5 (nga IHMK, Ambasada Amerikane, Komuna e Prishtinës etj.) dhe në baza ditore ka përgatit raporte për situatën e krijuar, posaçërisht në Prishtinë për të njoftuar publikun për cilësinë e ajrit, shkaqet e ndotjes dhe kushtet meteorologjike.

Gjatë viti 2016, bazuar në të dhënat e IHMK, kishte tejkalime të theksuara të VML për PM2.5 në Prishtinë (IHMK dhe Rilindje), Drenas, Gjilan dhe Obiliq (Figura 6).

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë




Figura 6: VML për PM 2.5 sipas stacioneve matës për vitin 2016

Të dhëna të detajuara për parametrat e cilësisë së ajrit sipas muajve të vitit 2016, janë prezantuar në **Shtojcën 1**, të këtij raportit dhe në Raportin Gjendja e Ajrit në Kosovë për vitin 2016, të cilin e gjeni në ueb faqen ammk-rks.net.

Krahasuar me vitin 2015, nuk vërehet ndonjë ndryshim në cilësinë e ajrit. Njëjtë sikurse gjatë vitit 2015 edhe gjatë vitit 2016, tejkalime janë regjistruar kryesisht për Parametrat PM10 dhe PM2.5, edhe atë stacionet monitoruese në Prishtinë, Obiliq, Drenas dhe Gjilan.

Të dhënat për trendin e cilësisë së ajrit për parametrat PM10 dhe PM 2.5, janë prezantuar të figurën 7 dhe 8, ndërsa trendi për parametrat tjerë është prezantuar në shtojcën 2 të raportit.




Figura 7: Trendi cilësisë për grimcat PM 10 për vitet 2012-2016

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë




Figura 8: Trendi i cilësisë për grimcat PM2.5 për vitet 2012-2016

Rekomandime:

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe mbrojtjes së tij nga ndotja si dhe me qëllim që të përmirësohet monitorimi dhe raportimi për cilësinë e ajrit rekomandohet, që:

- Të implementohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit,
- Të zbatohet Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga ndotja dhe aktet nënligjore që dalin nga ky ligj,
- Të kompletohet inventari i emisioneve dhe burimeve të ndotësve në ajër,
- Të funksionalizohet plotësisht sistemi nacional për monitorimin e cilësisë së ajrit me qëllim të përmirësimit të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave për cilësinë e ajrit,
- Të zbatohet sistemi i drejtpërdrejtë online (në kohë reale) i raportimit të të dhënave për cilësinë e ajrit,
- Të forcohen kapacitetet teknike dhe institucionale për mirëmbajtjen e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit, servisimin dhe kalibrimin e pajisjeve si dhe të bëhet akreditimi i laboratorit për cilësinë e ajrit.
- Të përmirësohet bashkëpunimi në mes të institucioneve monitoruese dhe operatorëve, e sidomos në procesin e rrjedhjes së informatave, përpunimit, raportimit të tyre dhe informimit më efikas të publikut për kualitetin e ajrit.

1.2. Uji

Edhe në Kosovë, si në shumë vende të botës, shëndeti i njeriut dhe plotësimi i nevojave të tij është gjithnjë e më tepër i kërcënuar nga mungesa e ujërave të pastra. Mbrojtja, ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së resurseve ujore është njëra prej sfidave me të mëdha mjedisore para shoqërisë sonë. Zhvillimi industrial, urbanizimi, bujqësia intensive janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore.

Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e as biologjik. E gjithë kjo ndikon që në trupat ujorë të kemi rritje të vlerave në parametrat fizikë, kimik dhe mikrobiologjik. Po ashtu, ndikime të shumëfishta vijnë edhe nga reshjet atmosferike: gazrat në ajër si (NO_x , SO_2 , CO_2 etj) gjatë reshjeve atmosferike formojnë shirat acidik, që në mënyrë direkte ndikojnë në rritjen e aciditetit në ujëra. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç'rast vije deri tek rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj) dhe atyre organike (PAH, PCB, Herbicide etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujorë janë shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

Monitorimin e ujërave të lumenjve në territorin e Republikës së Kosovës e bënë Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Cilësia e këtyre lumenjve përcaktohet në bazë të analizave fizike, kimike dhe metaleve të rënda. Rrjeti i monitorimit ka gjithsej 54 vendmostrime (stacion monitoruese). Parametrat fizik që aktualisht monitorohen janë 10 parametra fizikë (maten 11 herë në vit), 39 parametra kimik (maten 11 herë në vit) dhe 8 metale të rënda (2 herë në vit).

Në **shtojcën 4 dhe 5 të raportit**, janë prezantuar stacionet monitoruese të lumenjve, parametrat që monitorohen dhe frekuenca e matjeve.

Në këtë raport gjendjen e ujërave e kemi pasqyruar përmes këtyre treguesve/parametrave: Oksigjeni i tretur/ mg/l O_2 ; Karboni organik total/ mg/l C; Shpenzimi biokimik i oksigjenit/ mg/l O_2 (SHBO₅); Shpenzimi kimik i oksigjenit/ mg/l O_2 (SHKO); Fosfori total/ mg/l P dhe Materiet totale të suspenduara/ mg/L (MTS). Vlerat e prezantuara në figurë janë si vlera mesatare për vitin 2015.

Parametrat si: oksigjeni i tretur (O_2), oksigjeni biokimik i shpenzuar për 5 ditë (SHBO₅), shpenzimi kimik i oksigjenit (SHKO), tregon nivelin e ndotjes organike dhe bakteriologjike të ujit i cili hyn në grupin e parametrave të cilët pritet të kenë presione nga ato dukuri që u cekën më lartë. Derisa, prezenca e fosforit (P_{tot}) shkakton eutrofikimin në ujëra.

Pellgu i Drinit të Bardhë – në këtë pellg përzgjedhja është bërë për dy lumenjtë: Lumi Drini i Bardhë dhe Lumi Ereniku, ku si vlera mesatare vjetore të ngritura paraqiten shpenzimi kimik i oksigjenit/mg/l O₂ (SHKO) si dhe vlera mesatare vjetore të parametrin materiet totale të suspenduara/mg/L (MTS). (Figura 9)




Figura 9: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjve- IHMK 2016(Pellgu i Drinit të Bardhë)

Pellgu i Ibrit – në këtë pellg përzgjedhja është bërë për këta lumenj: Ibri, Sitnica, Prishtevka, Graçanka dhe Drenica (figura 10), nga ku vërehet se Lumi Prishtevka/Bresje, pothuajse me të gjithë parametrin e paraqitur tregon vlera më të ngritura, ngase vetë shtrirja e lumit është përgjatë zonës më të populluar dhe që ngërthen në vete edhe zonat industriale.

Meqenëse, gjatë vitit 2016 ka pasur shumë polemika rreth ndotjes në lumin Drenica, IHMK ka bërë matjen edhe në një vendmostrim shtesë në vitin 2016 (02_062B) lumi Drenica - vendmostrim në Çikatovë e Vjetër. Nëse bëhet krahasimi i të dhënave për cilësinë e ujit përgjatë rrjedhjes, rezulton se kemi vlera më të ulët të oksigjenit të tretur nga 7.04 mg/l O₂ në 4.73 mg/l O₂, kurse parametri, materia totale e suspenduar (MTS) tregon ngritje të vlerës mesatare vjetore nga 12 mg/l në 20.85 mg/l. Kjo gjendje mund të shpjegohet nga ndikimi që vjen për shkak të shkarkimeve të ujërave nga fabrika e Feronikelit.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë




Figura 10: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve- IHMK 2016(Pellgu i Ibrit)

Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit - në pellgun Morava e Binçës është përzgjedhur lumi Morava e Binçës me gjithsej katër stacione monitoruese (figura 3), ku pothuajse në të gjitha stacionet e saja monitoruese tregon ngritje të këtyre gjashtë parametrave. Ndërsa në Pellgun Lepencit (Figura 11), janë përzgjedhur dy lumenj: ai i Lepencit dhe Nerodimja.




Figura 11: Treguesit e përzgjedhur nga monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenjëve- IHMK 2016 (Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit)

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Bazuar në këto tri figura (shtrirjen territoriale në të gjitha pellgjet) ku prezenca e sasisë së fosfori total/ mg/l P nga analizat e bëra gjatë kësaj periudhe tregojnë se sasia e fosforit në ujërat e lumenjve nuk do të paraqesin ndikim aq të shprehur tek ujërat sipërfaqësore, sepse vlerat e tij të paraqitura në diagramet gjendet në mes 0.136 mg/l P (Lepenci/Prevallë-Subainë) dhe 6.494 mg/l P (Prishtevka/Bresje). Nga konstatohet se ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuar me eutrofikim.

Poashtu, edhe treguesi shpenzimi biokimik i oksigjenit (SHBO₅), gjatë periudhës së monitorimit për vitin 2016, vlerat e përllogaritura gjenden në mes të 0.525 dhe 107.38 mg O₂/l, që tregojnë për ndotje me vlerën më të lartë mesatare vjetore në lumin Prishtevka/Bresje. Edhe pse në kushte natyrore ujërat e pastra nuk posedojnë fare sasi të SHBO₅, por kjo ndotje arsyetohet me faktin që ujërat sipërfaqësore iu ekspozohen gjithnjë dhe gjithandej më shumë shkarkimeve të ujërave të ndotura përmes të cilave dhe krijohen kushte optimale për rritjen e vlerës së SHBO₅.

Në tabelën 3, është prezantuar trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve për treguesit e përzgjedhur për periudhën 2015-2016, sipas stacioneve monitoruese.

Tabela 3: Trendi i cilësisë së ujërave të lumenjve 2015-2016

Stacionet monitoruese	Oksigjeni i tretur/ mg/l O ₂	Shpenzimi biokimik i oksigjenit/ mg/l O ₂ (SHBO ₅)	Shpenzimi kimik i oksigjenit/ mg/l O ₂ (SHKO)	Karboni organik total/ mg/l C	Fosfori total/ mg/l P	Materiet totale të suspenduara/ mg/L (MTS)
RV01_011	↓	↓	↓	↓	*	↔
RV01_012	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV01_013	↓	↑	↓	↑	↑	↑
RV01_071	↓	↓	↓	↓	*	↔
RV01_072	↑	↑	↑	↑	↑	↓
RV02_011	↑	↓	↓	↓	*	↓
RV02_012	↑	↑	↑	↑	↑	↓
RV02_013	↓	↑	↑	↑	↑	↓
RV02_023	↓	↑	↑	↑	↑	↑
RV02_024	↑	↑	↓	↑	↑	↓
RV02_026	↓	↑	↑	↑	↑	↓
RV02_041	↓	↑	↑	↑	↑	↓

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

RV02_051	↓	↑	↓	↑	↑	↓
RV02_061	↓	↓	↓	↓	*	↑
RV02_062	↓	↑	↓	↓	↑	↓
RV03_011	↓	↓	↓	↓	*	↔
RV03_012	↓	↑	↓	↑	↑	↓
RV03_013	↓	↑	↓	↑	↓	↓
RV03_014	↓	↓	↓	↓	↓	↓
RV04_011	↓	↓	↓	↓	*	↔
RV04_012	↑	↑	↓	↑	↓	↓
RV04_013	↑	↑	↓	↑	↑	↓
RV04_021	↓	↓	↓	↓	*	↔
RV04_023	↓	↑	↑	↑	↑	↓
RV04_024	↑	↑	↑	↑	↑	↓

Përveç cilësisë së ujërave, IHMK bën edhe monitorimin e sasisë së ujërave. Monitorimi i sasisë së ujërave bëhet përmes rrjetit hidrometrik i cili përbëhet nga një numër i stacioneve matëse nëpër lumenj, ku kryhen matje për sasinë e ujit. Rrjeti hidrometrik përbëhet nga 25 stacione hidrometrike. Në këto stacione matet Niveli (h) dhe Prurja (Q). Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhënat për nivelin e ujit H (m), për stacione hidrometrike për matjet e nivelit të realizuara për vitin 2016.

Tabela 4: Vlerat mesatare vjetore të nivelit H (cm) sipas stacioneve matëse²

Stacioni	Mes. (m)	Max. (m)	Min. (m)
Berkovë	1.04	1.91	0.79
Drelaj	0.67	1.81	0.31
Grykë e Rugovës	0.69	1.40	0.38
Klinë	0.65	1.76	0.46
Mirushë	0.75	2.51	0.55
Deçan	0.47	1.20	0.27
Këpuz	1.30	4.29	0.68
Gjakovë	0.68	2.94	0.28
Piranë	1.12	2.96	0.82
Gjonaj	2.99	6.35	1.43
Prizren	0.56	0.88	0.42
Drenas	1.24	2.62	0.86
Lluzhan	1.01	3.72	0.56

² Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Nedakovc	1.58	3.33	1.31
Vragoli	0.69	2.58	0.43
Caralev	0.27	1.05	0.14
Milloshëvë	1.61	4.09	0.93
Leposaviq	1.81	4.11	1.28
Konçul	2.56	5.90	1.95
Domorovc	0.49	1.46	0.27
Viti	0.62	1.21	0.42
Kaçanik	0.42	1.00	0.30
Brod	0.73	1.34	0.53
Hani i Elezit	0.73	1.86	0.42
Mlikë	0.77	1.16	0.54

Me qëllim të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore gjatë vitit 2015-2016, MMPH, ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Ujërave 2017-2034. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është, menaxhimi efektiv i ujërave si një element qenësor i zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me parimin e menaxhimit të integruar të ujërave, strategjia ka qasje të gjerë multi sektorale që përpiqet të përfshijë të gjitha aspektet e rëndësishme të menaxhimit të ujërave në Republikën e Kosovës, duke përfshirë përveç, tjerash edhe shërbimet më ujë të popullsisë dhe ekonomitë në zonat e banuara me: furnizim me ujë, mbledhjen e ujërave të zeza si dhe trajtimin e ujërave të zeza³. Me këtë strategji po ashtu janë definuar edhe objektivat strategjike për shfrytëzimin eficient të ujërave, si dhe qeverisje të drejtë dhe efektive të ujërave.

Rekomandimet:

- Mungesa e monitorimit të ujërave nëntokësore dhe parametrave biologjik është një problem që kërkon zgjidhje.
- Vëmendje dhe rendësi të veçantë duhet t'i kushtohet edhe ngritjes së infrastrukturës ujore, ngritjes së impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave,
- Kompletimi i legjislacionit në sektorin e ujërave dhe transpozimit të tij me direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Ujëra, janë ndër prioritetet kyçe të sektorit.

³ Strategjia Kombëtare për Ujëra e Kosovës 2017-2034

1.3. Toka (dheu)

Toka edhe pse vlerësohet pasuri vitale e çdo vendi, kujdesi dhe sjellja e shoqërisë tonë ndaj tokës dhe mjedisit, vazhdon të mos jetë në nivelin e duhur. Në përgjithësi në gjithë vendin përkundër progresit të arritur nga institucionet qendrore dhe lokale, akoma vërehen dukuri negative si; pyje të prera dhe që prehen, pyje të djegura, erozion dhe degradim të lumenjve nga shfrytëzimi pa kriter, degradim të peizazheve natyror, humbje të burimeve tokësore dhe ndryshim të destinimit të tokës nga ndërtimet kaotike urbane dhe rurale, përmbytjet dhe vërshimet etj. Mijëra hektarë tokë bujqësore vlerësohet së janë zënë me ndërtime nga urbanizmi kaotik urban dhe rural. Të gjitha këto dukuri negative janë vetëm njëra ndër faktorët që po ndikon në degradimin e tokës në vend.

Industria, bujqësia, mbeturinat, transporti, dhe ujërat e përdorura janë një ndër ndotësit kryesore të ndotjes së tokave në Kosovë. Shumë vende përreth industrive të renda, si Obiliq, Mitrovicë, Drenas, Han te E lezit, ndotja e tokës vlerësohet se është mjaftë evidentet. Shqetësimi edhe me i madhe është se këto industri janë në funksion me vite të tëra. Industritë e renda bëjnë shkarkimin e ndotësve në mjedis, çka ndikon edhe në ndotjen e tokës nga prania e mbetjeve të rrezikshme qoftë të metaleve të renda apo kemikaleve.

Ky trend i ndotjes dhe degradimit të tokës akoma është në rritje, përkundër shumë masave të ndërmarra nga institucionet lokale dhe qendrore. Pothuajse prej vitit 2000 e deri me sot tokat po shpërdorohen dhe mjedisi vazhdon të degradohet sidomos përgjatë rrugëve kryesore lokale dhe regjionale të Kosovës.

Përgjatë këtyre rrugëve tokat e shumta janë duke u zënë nga objektet e ndryshme afariste pa një strukturë të mirëfillte të planifikimit. Kësaj dukurie ju ka mundësuar mungesa e planeve rregulluese dhe urbanistike nga komunat. Komunikimi akoma jo i mirëfilltë ndërmjet komunitetit, institucioneve lokale dhe qendrore, ka rezultuar me mungesë të të dhënave për numrin e ndërtimeve pa leje në tokat bujqësore, meqë komunat nuk dërgojnë të dhënat të sakta apo jo të plota në Ministrinë e Bujqësisë, pavarësisht se ato janë të obliguara me ligj(Ligji për tokat bujqësore, nr. 02L-26), që të raportojnë për degradimin e tokës bujqësore. Sipas vlerësimeve të zyrtareve të MBPZHR, për çdo vit i ndërrohet destinimi i tokave bujqësore 400-500 ha.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Në nivelin lokal përkundër shumicës së komunave të Kosovës me drejtoritë komunale për bujqësi, akoma duhet të punohet shumë në krijimin dhe në mbështetjen e mëtutjeshme të reformave të politikave, në mënyrë që të krijohet një ambient politik sa më favorizues për zhvillimin e menaxhimit të tokave në vend. Vlera dhe potenciali i burimeve tokësore në vend po ndryshon nga një vend në tjetrin, por që vlerësohet akoma me një trend negativë.

Përdorimi i tokës

Përdorimi i tokës vlerësohet si përdorim i sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore – tokave punuese, fushave, livadheve, pyjeve dhe Kullota, kultura shumë vjeçar edhe përmishte të përdorura nga ekonomia bujqësore, pavarësisht nga lloji etj.

Rezultatet e Regjistrimit të Bujqësisë tregojnë se në Kosovë janë gjithsej 130,775 Ekonomi Bujqësore, që janë marrë me aktivitete bujqësore, nga të cilat 130,436 janë Ekonomi Familjare Bujqësore dhe Biznese Individuale, ndërsa 339 janë Subjekte Juridike. Subjektet Juridike kanë kontribuar me më pak se 0.2% në numrin e Ekonomive Bujqësore, ndërsa 2% në sipërfaqen e shfrytëzuar të tokës bujqësore.⁴

Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2015 ishte 410.427 ha. Pjesa më e madhe e tyre janë: livadhet dhe kullotat (përfshirë tokën e përbashkët) ose 216.481 ha (52.7%). Tokat e kultivuara - fusha të cilat përfshijnë rreth 45.6%, shumica prej tyre janë drithëra gruri. Drithërat e grurit u mbjellën në 72.8% (134,886.34 hektarë) të sipërfaqes së tokës bujqësore, ose 32.9% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore të shfrytëzuar.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë në vitin rreth në vitin 2015, rreth 6787 ha të tokës bujqësore ka qenë e pa shfrytëzuar, e klasifikuar si tokë djerrin, ndërsa toka të punueshme ara kanë qenë 185386 ha.⁵ Për vitin 2016, akoma nuk kemi të dhënat statistikore për shfrytëzim të tokave në vend.

Në Kosovë sektori i bimëve medicinale dhe aromatike si në kultivim ashtu edhe në grumbullim është mjaftë i konsoliduar llogaritet diku 160 ha të kultivuara si dhe 179,580 ha zona të certifikuar për grumbullim të bimëve mjekësore dhe frutave të egra. Janë 5 kompani të certifikuar të cilat bëjnë grumbullimin e

⁴Raporti i Gjelber 2015, MBPZHR

⁵Pytesori e Ekonomive Bujqësore 2015, ASK

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

këtyre bimëve dhe 45 qendra të grumbullimit në tere Kosovën. Eksporti behet si produkt gjysme i përpunuar dhe 95% e prodhimit eksportohet jashtë Kosovës.⁶

Vlen të përmendet se Ligji për rregullimin e tokës (Nr. 04/L-040, 2012), përcakton institucionet përgjegjëse për rregullimin e tokës; Ministria, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Komuna dhe Zyra Kadastrale të Komunave.

Ministria e Bujqësisë në harmoni me Planin zhvillimor Komunal propozon zonat kadastrale apo pjesët e zonave kadastrale të cilat do të rregullohen me projektin e rregullimit të tokës. Agjencioni Kadastral i Kosovës zotëron të dhënat e përgjithshme për rregullim të tokës të cilat janë:

- Zonat kadastrale
- Sipërfaqja e tokave sipas kulturave
- Numri i parcelave kadastrale
- Numri i pjesëmarrësve

Në forma tjera direkte apo indirekte rreth menaxhimit dhe administrimit të tokës në Kosovë involvohen një seri ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative si nga Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit dhe Institucioneve tjera.

Siç është e njohur se mbrojtja e tokave dhe zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë varet shumë nga përgatitja dhe zbatimi i drejt i politikave të tokës. Këto politika janë çelës i kontrollit të degradimit të tokës dhe përmirësimit të shfrytëzimit të tokës bujqësore, duke u bazuar në kapacitetet e saj prodhuese.

Monitorimi i tokave

Në Kosovë akoma nuk ka sistem të monitorimit të tokave. Një studim për ndotjet e tokave bujqësore është realizuar në saje të fondeve të EU dhe i implementuar nga GIZ dhe NIRAS. Projekti është realizuar brenda 2 viteve 2013-2015. Ky projekt ka monitoruar tokat bujqësore të 17 komunave të Kosovës i cili ka përfshirë 214.749 ha. Sipas projektit mostrat e tokës kanë rezultuar të kontaminuar afër vendeve industriale dhe që nuk përdoret për kultura bujqësore.

⁶ *Burimi: Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje / MBPZHR*




Figura 12. Monitorimi i tokave në komuna e Kosovës nga projekti "Studimi i ndotjes së tokave bujqësore ne Kosovë"⁷

Institucionet përgjegjëse për monitorim të tokave janë; Instituti Bujqësor i Kosovës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Të dy këto institucione veprojnë në kuadër të ministrive përkatëse.

Instituti Bujqësor i Kosovës si përgjegjësi ka;

- Mbështetja teknike dhe shkencore për departamentet teknike të MBPZHR-së,
- Kontrolli i cilësisë së in puteve bujqësore, ushqimit dhe ruajtja e ambientit jetësor,
- Hulumtimi i varieteteve të kulturave bujqësore (grurit, elbit, misrit dhe patates) në kushtet agroekologjike të Kosovës.
- Punët hulumtuese në drejtim të krijimit të kultivarëve të grurit, hibrideve të misrit etj.,
- Punët përgatitore rreth krijimit të bankës së gjeneve për kulturat e ndryshme,
- Vlerësimi i cilësive prodhuese dhe bonitetit të tokave në Kosovë,

⁷ Soil Country Report, Soil country analyses, AMMK, 2015

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

- Hulumtimi, identifikimi dhe inventarizimi agjentëve të dëmshëm biologjik (dëmtuesve, patogjenëve, barojave të këqija etj.) në Kosovë etj.⁸

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka këto përgjegjësi:

- Bene monitorimin e ndotjes së tokave në tërë territorin e Kosovës, sipas programit të monitorimit;
- Bene rishikimin e rrjetit nacional të monitorimit të cilësisë së dheut dhe jepet propozimet për ndryshimet eventuale të tij sipas nevojës.
- Monitoron cilësinë e dheut dhe kryen analizat laboratorike edhe në raste të veçanta.
- Vlerëson dhe analizon rezultatet e mbledhura nga monitorimi i cilësisë së dheut dhe harton raporte nga monitorimi i cilësisë së dheut;
- Përgatitë procedurat operative për analizat laboratorike të dheut sipas normativave evropiane për matjet laboratorike;

Në bazë të vlerësimeve kollaudojmë se degradimi i tokave është si rezultat i disa faktorëve specifik, si;

- Mungesa e zbatimit të ligjeve për token dhe tjera;
- Ndotja dhe degradimi i mjedisit;
- Ndotja e burimeve ujore dhe tokave për shkak të menaxhimit të dobët të mbeturinave urbane, industriale, kafshëve dhe mungesës së objekteve të trajtimit të ujërave përdorura;
- Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore dhe i hapësirës;
- Tipi i shpërndarë dhe pa planë i vendbanimeve;
- Ndërtimet e shumta ilegale;
- Mungesa e sistemit informative për tokat;
- Mungesa financiare dhe teknike për përmirësim të tokave;
- Eksplozimi i urban i popullatës;
- Menaxhim i ultë i tokave nga komunat;
- Mungesa në informimin e komunitetit për menaxhim të pronës private;
- Mungesa e infrastrukturës në nivele lokale;
- Mungesa e përvojës në hartimin dhe zbatimin e politikave për menaxhim të tokave;
- Mungesa e statistikave gjithëpërfshirëse për menaxhim të tokave;

Si rezultat e këtyre faktorëve ekziston rreziku permanent për;

⁸ <http://www.mbpzhr-ks.net/sq/instituti-bujqesor-i-kosoves>

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

- Humbja e pakthyeshme e resurseve natyrore dhe vlerave të krijuara dhe të trashëguara;
- Rritja e nivelit të ndotjes së tokave, sidomos afër vendeve industriale;
- Ndotja e ujit për ujë të tokës bujqësore;
- Betonimi dhe ngjeshja e tokës;
- Përkushtimi i vogël i fermerëve për mbrojtje dhe prodhimtari bujqësore;
- In pte të larta të investimeve në zhvillimin e një sistemi efektiv menaxhues të tokave dhe outpute të vogla;

Rekomandimet:

- Politikat më të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit të tokave,
- Respektim të legjislacionit,
- Mbrojtje të mjedisit në mënyrë vazhdueshme,
- Investime në përmirësimin e infrastrukturës me të gjitha faktorët përcjellës të saj,
- Beneficione në formë garantëve dhe mbështetje financiare,
- Te hartohet programi i monitorimit të përhershëm i tokave bujqësore dhe atyre industriale,
- Monitorimi i degraduesve të tokës nga aktivitet natyrore dhe humane,
- Planifikimi i përdorimit të tokës për një zhvillim të qëndrueshëm.

1.4. Zonat mbrojtura dhe biodiversiteti

Zonat e Mbrojtura- Numri i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2016) është 173 dhe përfshijnë sipërfaqe prej 126070.29 ha , ose 11.55% e sipërfaqes të Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 19 Rezervate Strikte të Natyrës, (“Koretnik”, “Lubeteni” “Rezervati i Arnenit”, “Maja e Ropsit”, “Rusenica”, “Kamilja”, “Pisha e Madhe”, Bistra, etj), 2 Parqe Kombëtare (PK “Sharri”, PK “Bjeshkët e Nemuna”), 1 Park natyre (Pashtriku dhe liqeni i Vërmicës) 146 Monumente të Natyrës (“Burimi i Drinit të Bardhë me shpellën e Radavcit”, “Shpella e Gadimës”, “Ujëvarat e Mirushës”, “Gryka e Rugovës”, “Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë”, “Trungu i Rrapit në Marash”, Shpella e Panorcit, etj.), 5 peizazhe (“Gërmia”, “Shkugëza”, etj.), dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve (“Ligatina e Hencit-Radeves”).

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri”, Parku i natyrës “Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës” Peizazhi i Mbrojtur “Germia” dhe MNRV “Ujëvarat e Mirushë” etj. (Tabela 5)

Tabela 5. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive (2016)

Kat. e IUCN-së	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja/ha	Pjesëmarrja e ZM në %
I	Rezervatet Strikte të Natyrës	19	10,885.82	0.99
II	Parqet Kombëtar	2	115,957	10.6
III	Monumentet Natyre	145	6,010.79	0.56
V	Park Natyre	1	5,934	0.5
V	Peizazh i Mbrojtur	5	2.437	0.2
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e	1	109.5	0.01
	Totali	173	126070.29	11.55

Gjatë vitit 2016 në zonat e mbrojtura në veçanti në Parqet Kombëtar (Sharri dhe Bjeshkët e Nemuna) ka pasur prerje ilegale të pyjeve, si në lokalitetin e Mushtishtit, Delloc, Kaçanikut (pjesa e PK. Sharri), Kozhnjerit, Baballoq dhe në Malet e Prilepit, etj. Po ashtu dhe në vitin 2016 kanë vazhduar ndërtimet ilegale në zonat e mbrojtura, kryesisht në Parqet Kombëtare “Bjeshkët e Nemuna” dhe Sharri. Ndërtime në këto zona janë bërë pa kriter dhe në kundërshtim me parimet e mbrojtje së natyrë.

Gjatë vitit - 2016 më iniciativën e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, janë përgatitur arsyeshmëritë profesionale për marrjen nën mbrojtje ligjore dhe 67 objekte /zona të reja të natyrës, prej tyre: 18 rezervat strikte të natyrës, 46 monumentet, dhe 3 Peizazhe të Mbrojtura. Gjatë kësaj periudhe është bërë

monitorimi i zonave të mbrojtura dhe dhënia e rekomandimeve si dhe mendimet profesionale për ndërhyrjen në natyrë.

Në 2016 financuar nga Qeveria e Kosovës është realizuar projekti për shenjëzimin e zonave të mbrojtura-monumenteve të natyrës, ku janë shenjëzuar 130 monumente të natyrës.

Biodiversiteti

Gjendja e florës dhe vegjetacionit- Kosova edhe pse është një shtet me sipërfaqe të vogël (10.908 km²) është mjaftë e pasur në aspektin e shumëllojshmërisë bimore. Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet së në Kosovë janë prezent afro 2.800 - 3.000 lloje të florës vaskulare.⁹

Prerja e pyjeve pa kriter, degradimi i habitateve, ndryshimet klimatike globale janë faktor që po ndikojnë direkt që lloje të ndryshme bimore dhe shtazore të përballen me rrezik të zhdukjes. Habitate të rëndësishme janë duke u dëmtuar e degraduar dhe ekosistemet po destabilizohen si pasojë e ndërhyrjes së njeriut në veçanti në ekosistemet afër vendbanimeve. Në vitet e fundit si pasojë e prerjes së pyjeve pa kriter dhe përfshirjes nga zjarret e sipërfaqeve të mëdha të pyjeve, lloje të ndryshme rrezikohen të humbin habitatin e tyre dhe ardhjes në shprehje të llojeve invazive të cilat shpesh arrijnë të ndryshojnë strukturën floristike të ekosistemeve.

Edhe pse fitodiversiteti i Kosovës është shfrytëzuar me shikuj, brengosë fakti që kohëve të fundit ky shfrytëzim është jo shumë racional dhe pa planifikim, gjë që në të ardhmen mund të rezultojë me pasoja të paparashikueshme. Dëme të mëdha po i shkaktohen bimëve mjekuese, aromatike dhe industriale nga grumbullimi pa kriter i tyre.

Gjendja e faunës- Në aspektin faunistik Kosova karakterizohet me një llojshmëri të madhe të llojeve edhe pse hulumtimet në këtë drejtim nuk kanë përfunduar.

Gjendja e përgjithshme e faunës është e mirë si rezultate i zgjerimit të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura. Dëmtimi i faunës në Kosovë ndodhë nga gjuetia ilegale që paraqitet kohë pas kohe, në veçanti gjatë vikendit në hapësirat e zonave të mbrojtura.

Nga gjuetia ilegale më të rrezikuar janë kaprojtë dhe dhitë e egra, ndërsa zhvillim të mirë kanë ariu i murrmë dhe ujku. Të rrezikuara janë gjithashtu edhe llojet e shpendëve grabitqar.

Llogaritet se në Kosovë jetojnë rreth 250 lloje të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave dhe mbi 500 taksonë të makrozoobentosit të ujërave. Numri i saktë i llojeve të faunës duhet të përcaktohet në bazë të inventarizimit që planifikohet të zbatohet

⁹ Libri i Kuq i flores vaskulare te Republikës të Kosovës

në të ardhmen si gjatë hartimit të Librit të Kuq për faunën ashtu edhe në kuadër të projekteve tjera.

Monitorimi i llojeve të rrezikuara të gjitarëve -Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit në zonat e mbrojtura të natyrës, gjatë vitit 2016/2017 AMMK-ja, përkatësisht Instituti për Mbrojtjen e Natyrës, ka vazhduar monitorimin e faunës më anë të kamerave kurth, në pjesë të ndryshme në dy Parqet Kombëtare, “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.

Vendosja e kamerave kurth është realizuar në disa pjesë të Parqeve, ku besohet se janë zona të mundshme e lëvizjes së kafshëve të egra. Gjatë kësaj periudhe janë siguruar të dhëna për praninë e llojeve të gjitarëve si: Rrëqebullit (*Lynx lynx*), Ari i murrmë (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dreri (*Cervus elaphus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Macja e egër (*Felis sylvestrus*), vjedulla (*Meles meles*) si dhe disa lloje tjera të zakonshme. Nga prania e numrit të konsiderueshëm të tyre mund të konstatohet se gjendja relativisht e mirë e faunës në zonat e mbrojtura, veçanërisht në Parqet Kombëtare (“Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”).



Foto nga regjistrimet e kamerave kurthe

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Rekomandimet:

- Të bëhet hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve dhe habitateve,
- Të hartohet Lista e Kuqe e faunës së Kosovës,
- Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore,
- Mbrojtja e habitateve të llojeve të rralla dhe të rrezikuara si dhe përgatitja e arsytetimeve profesionale për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitateve sipas rrjetit ekologjik Natyra 2000.
- Themelimi i organeve menaxhere për zonat e mbrojtura,
- Aprovimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”
- Hartimi i Planit Menaxhues për për Parkun Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”
- Ngritja e kapaciteteve të punonjësve në zonat e mbrojtura,
- Rritja e stafit në IKMN.

1.5. Mbeturinat

Gjendja e deponive sanitare në Kosovë edhe në vitin 2016 nuk është e mirë si pasoje e shumë faktorëve e në veçanti nga mungesa e menaxhimit sipas standardeve për menaxhim të deponive. Karakteristikë negative e këtyre deponive është ujërrjedhat e ujërave nga deponit në mjediset përreth dhe mos monitorimi i tyre nga ana e kompanive menaxhuese. Kompaktimi dhe mbulimi i mbeturinave akoma nuk është e nivelit të standardeve sipas kriterëve që kërkohen.

Një progres të përmirësimit në aspektin e mirëmbajtës në krahasim me vitet e kaluara, (përveç Deponisë së Pejës gjendja e të cilës është e rënd për shkak të stërmbushjes me mbeturina dhe mungesës së hapësirës), është mbulueshmeria e mbeturinave me dhe për pjesët e mbushura. Kjo ka ndikuar në përmirësimin e gjendjes për evitim të kundërmimit dhe frekuentim të shpezëve dhe qenve endacak.



Mbulueshmeria e mbeturinave me shtresa të dheut në deponinë sanitare në Mirash

Sasia e deponuar e mbeturinave

Sasia e mbeturinave të gjeneruar dhe të deponuara në deponite sanitare në Kosovë është në rritje siç vërehet edhe nga tabela 5. Sasia më e madhe e mbeturinave është deponuar në deponinë sanitare në Mirash ndërsa sasia më e vogël në deponinë sanitare në Podujevë.

Tabela 6: Sasia e mbeturinave sipas deponive sanitare 2013-2016

Deponitë Sanitare	Totali në ton 2013	Totali në ton 2014	Totali në ton 2015	Totali në ton 2016
Prishtinë	89,806.18	88,803.29	104,742.68	116,529.00
Gjilan	36,378.46	21,263.30	38,244.60	45,311.82
Prizren	58,994.49	44,490.70	79,661.07	89,897.79
Podujevë	7,858.09	7,679.20	10,315.42	10,552.70
Pejë	36,475.00	38,950.00	44,424.00	48,342
Mitrovicë	36,190.61	40,284.64	39,546.52	43,863.36
Ferizaj	14,345.26	23,462.00	13,801.23	12,904.16
Totali i deponive	280,048.09	264,933.13	330,735.52	367,400.83

Kjo rritje e deponimit vërehet edhe në bazë trendit të deponimit të mbeturinave në deponi për vitet 2009-2016. (Fig.13).




Figura 13. Sasia e deponuar 2009-2016

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Në deponit sanitare te menaxhuara nga KMDK-ja, (Mirashit-Obiliq, Podujevë, Sharr, Gjilan, dhe Prizren), për vitet 2015-2016, deponimi i mbeturinave rezultojë te jete me i lartë në vitin 2016 për 28442.41 ton. Në vitin 2015 janë deponuar 246753.06, ndërsa në vitin 2016 janë deponuar 275195.47 ton. (Fig.14).




Figura 14. Trendi i deponimit të mbeturinave në deponit sanitare për vitet 2015-2016, te menaxhuara nga KMDK-ja

Deponitë e menaxhuara nga komunat (Pejë dhe Mitrovicë), vërehet një trend i rritjes së deponimit të mbeturinave në këto deponi. Në deponinë e Mitrovicës për vitin 2016, janë deponuar mbeturina prej 43863.36 ton. Rritja e sasisë së mbeturinave në deponi gjatë viteve 2015-2016, ka rezultuar gjatë muajve Korrik-shtatore, për shkak të mbetjeve organike bujqësore. Në këtë deponi, deponohen mbeturinat e komunave; Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj.




Figura 15. Trendi i deponimit të mbeturinave në deponinë e Mitrovicës për vitin 2015-2016

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Në deponinë sanitare të Pejës, për vitin 2016, janë deponuar 48342 ton. (Fig.16). Sikur vërehet edhe nga figura gjatë muajve Korrik-Shtatorë është rritur dukshëm deponimi i mbeturinave për shkak të rritjes së mbeturinave organike. Në këtë deponi frekuentojnë disa komuna (Pejë, Deçan, Klinë dhe Istog).




Figura 16. Sasia e deponuar e mbeturinave në deponin e Pejës për vitin 2016

Nëse bëhet krahasimi i sasisë së deponuar të mbeturinave në dy deponit komunale, vërehet se sasia më e madhe e mbeturinave deponohet në deponin e Pejës.(Fig. 17).




Figura 17. Sasia e deponuar e mbeturinave (Pejë dhe Mitrovicë), për vitin 2016

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Deponitë ilegale - Gjatë muajit maj, 2016, AMMK ne bashkëpunim me GIZ ka bërë identifikim dhe rivlerësimin e deponive ilegale ne 17 komunat e Kosovës të cilat janë pjese e projektit te GIZ “Gara për mjedis te pastër”. Për identifikimin e këtyre deponive ilegale u formuan grupe të terrenit me përbërje: ekspert nga AMMK, GIZ, zyrtar nga komunat dhe Kompania Regjionale për Mbeturina dhe OJQ. Në vitin 2017, ka vazhduar përsëri me te njëjtin projekt, për rivlerësim te deponive ilegale ne 17 komunat si dhe evidentimin e deponive ilegale ne 21 komunat tjera.

Në tabelën 7 janë te paraqitura të dhënat ne forme tabelore për numrin e deponive ilegale të identifikuara nëpër 17 komuna gjatë vitit 2016. Në total pas rivlerësimit te dhënave, janë identifikuar 1117 deponi ilegale. Në bazë të të dhënave të grumbulluara numri më i madhe i deponive ilegale është identifikuar në komunën e Drenasit (137), ne Pejë (121), në Lipjan (105) dhe atë të Prishtinës (94).

Tabela 7. Numri i deponive ilegale sipas komunave 2016

Nr.	Komuna	Numri i deponive ilegale
1	Drenas	137
2	Graçanica	32
3	Obiliq	53
4	Ferizaj	61
5	Istog	82
6	Klina	57
7	Fushe Kosova	42
8	Kaçanik	35
9	Lipjan	105
10	Podujeve	35
11	Skenderaj	71
12	Mitrovicë	38
13	Prishtine	94
14	Vushtrri	57
15	Peja	121
16	Shtime	27
17	Gjakovë	70
	Totali	1117

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Mbeturinat spitalore- Këto mbeturina trajtohen në 7 impiante për trajtimin e tyre të cilat janë të vendosura në qendrat kryesore të spitaleve në Kosovë. Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga AMMK kemi rritje të sasisë së mbeturinave spitalore të trajtuara nga viti 2014 me 417822 kg, në vitin 2015 me 481375 kg, dhe vitin 2016 janë 520485.8 kg të trajtuara.

Sasia më e madhe e mbeturinave spitalore të trajtuar për vitin 2016 është në impiantin e vendosur në zonën e QKUK-së në Prishtinë ndërsa trajtimi me sasi më të vogël është në impiantin në Gjakovë. Përpos impiantit të Gjakovës, të gjithë të tjerët janë duke funksionuar me kapacitet të plotë në trajtimin e mbeturinave spitalore. (tabela 8).

Tabela 8: Sasia e mbeturinave spitalore të trajtuara për vitin 2015-2016

Nr.	Impianti	Sasia/kg/2015	Sasia /Kg/2016
1	Prishtine	205967	230370
2	Prizren	91760	93981.8
3	Pejë	44418	49403
4	Ferizaj	52082	57795
5	Gjilan	26591	22936
6	Gjakove	9365	2160
7	Mitrovice	51192	66000
8	Totali	481375	520485.8

Trajtimi i mbeturinave në Kosovë- Gjatë vitit 2015-2016 AMMK ka bërë identifikimin e të gjitha kompanive që merren me trajtimin e mbeturinave në Kosovë. Si rezultat i këtij hulumtimi ka dalë se në Kosovë janë gjithsej 72 kompani të cilat merren me trajtim të mbeturinave. Komunitet me më së paku kompani për trajtimin e mbeturinave janë Deçani, Ferizaj, Skenderaj Klina dhe Graçanica me nga një kompani ndërsa komunitet me më së shumti kompani janë Vitia, Podujeva dhe Prishtina. Në tabelën në vijim janë paraqitur llojet e trajtimit të mbeturinave dhe numrin e kompanive që merren me to. (tabela 9).

Tabela 9: Numri i kompanive që merren trajtim të mbeturinave

Nr.	Lloji i mbeturinave që trajtohen	Numri i kompanive
1	Mbeturina Metalike	55
2	Mbeturina Elektrike dhe Elektronike	19

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

3	Mbeturina te Plastikes	36
4	Akumulator	14
5	Mbeturina te letrës dhe kartonit	12
6	Mbeturina te gomës	5
7	Tjera	11

Mbeturinat industriale

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Mbeturinave Industriale (AMI) për vitin 2015. Rezultatet tregojnë për industrinë, përkatësisht për sektorët e aktiviteteve vijuese: B-Xehetari dhe Guroret, C- Prodhimi, D- Furnizimi me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar, E- Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim i mbeturinave dhe rregullim toke, F- Ndërtimtaria, G-U - Sektorët e Shërbimeve.

Rezultatet e paraqitura në këtë botim janë burim i rëndësishëm statistikorë për mbeturinat e gjeneruara dhe përpunuara nga sektorët e industrisë siç janë: B, C, D, E, F, G-U. Njësi raportuese në anketë kanë qenë bizneset me 10 e më shumë punëtorë.

Rezultatet nga anketa tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave të gjeneruara ka qenë në sektorët e Xehetarisë dhe Gurëthyesve 200 697 tonë ose 83%.

Gjithsej, sasia e gjeneruar e mbeturinave të rrezikshme ka qene 8 193 tonë ose 3%. Ndërsa, sasia më e vogël e mbeturinave të gjeneruara për vitin 2015, ka qenë në sektorin e industrisë përpunuese me vetëm 15 tonë.

Përpunimi i mbeturinave sipas llojit të industrisë tregon se sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara ka qenë nga prodhimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit si dhe nga ndërtimtaria.¹⁰

¹⁰ASK, Anketa e Statistikave Industriale 2016.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Nga vlerësimi i gjendjes mundë të vijmë në këto përfundime:

- Deponit sanitare (Regjional dhe Komunale), akoma nuk menaxhohen me norma dhe standarde sipas legjislacionit për menaxhim të deponive dhe Direktiva mbi deponinë e mbeturinave (99/31 / EC) dhe Urban Waste Water Treatment Directive (91/271.EEC).
- Në të gjitha deponit behët rrjedha e ujërave te zeza në mjedis të hapur,
- Në çdo deponi bëhet përzierja e ujërave sipërfaqësor dhe asaj të deponisë,
- Deponia Komunale në Pejë është e mbingarkuar me mbeturinat dhe mungesës së hapësirës së re,
- Në disa pjesë të deponisë në Sharr është e mbingarkuar nga deponia dhe nuk ka mbulim më shtresa të dheut,
- Nuk bëhet ndarja, riciklimi dhe ripërdorimi i mbeturinave,
- Kundërmimi, frekuentimi i qenve endacak dhe njerëzve jo zyrtare në deponi është evidentë në çdo depon, veçanërisht në deponit e Gjilanit, Mitrovicës dhe Pejës..
- Në asnjërën deponi nuk bëhet monitorimi i ujërave rrjedhës dhe pikave të ndjeshme mjedisore nga kompanit menaxhuese.

Rekomandimet

Për shkak të gjendjes jo të mirë të deponive të mbeturinave urbanë në Kosovë dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes teknike, menaxheriale dhe mjedisore , rekomandon si me poshtë;

- Respektimi i legjislacionit vendore dhe direktivave evropiane për menaxhim të deponive,
- Menaxhim me i mirë i deponive nga kompanit menaxhuese,
- Rifunksionalizimi i lagunave dhe pompave nëpër te gjitha deponitë e mbeturinave,
- Zgjerimi i hapësirës së deponisë së Pejës,
- Kompresimi dhe mbulimi i mbeturinave të bëhet sipas rregullave dhe standardeve,
- Mbulimi i sipërfaqeve të mbushura me mbeturina për të reduktuar kundërmimin, shpërndarjen e mbeturinave, shmangien e brejtëseve, qenve endacak dhe për të ulur rrezikun e zjarreve.
- Ruajtja e shëndetit të punonjësve që mbikqyrin deponit,
- Ndalimi i frekuentimit të qytetarëve të paautorizuar për t'iu shmangur dhe mbrojtur shëndetin e tyre nga ndotësit e deponive,
- Pakësimi i mbeturinave në deponi dhe fragmentimi i tyre në burim,
- Instalimi i pajisjeve matëse për emetimet e gazrave nga deponia,
- Të behet monitorimi i ujërave rrjedhës të deponive.

3. Mjedisi dhe shëndeti publik

Ndotja e mjedisit me theks të veçantë ndotja e ajrit dhe ujit është një ndër rreziqet me serioze për shëndetin e popullatës, kafshëve dhe bimëve. Ndotja e mjedisit për vitin 2016 ishte në fokus të prioriteteve nga MMPH. Ndonëse edhe ne vitin 2016, shkarkimet e emisioneve nga ndotësit kanë ndikuar në ndotjen e ajrit, ujërave dhe tokës, veçanërisht në pjesët urbane dhe industriale të vendit. Një ndër ndotësit me te mëdhenj janë vlerësuar industria energjetike, industria metalurgjike, minierat, deponitë minerare, industriale dhe urbane, deponitë ilegale të mbeturinave, transporti, bujqësia etj.

Në përgjithësi të gjitha presionet në mjedis nga ndotësit, ndikimet socio-ekonomike, ndryshimet klimatike mund të faktor negative që ndikojnë në shëndetin e popullatës. Këto efektet në shëndet varen në rend të parë nga ndjeshmëria e popullsisë, kohëzgjatja e ekspozimit dhe aftësia e përshtatshmërisë. Pikërisht format e shfaqjes së sëmundjeve ambientale janë të varur nga faktorët ekologjik, socio-ekonomik, aktivitetet e njeriut në natyrë, qasja në kujdesin shëndetësor, imunitetin e popullatës si dhe informimi.

IKSHP si institucion për monitorim dhe parandalim të sëmundjeve ambientale, ka zhvilluar një sistem të informimit shëndetësor për publikun, në të cilën kjo ka një rëndësi të jashtëzakonshme për sigurimin e informacionet për sëmundjet me origjinë ambientale. IKSHP bënë monitorimin e gjendjes së shëndetit publik e në veçanti e bënë përcjelljen e sëmundjeve të shkaktuara nga epidemitë dhe pandemitë, lëndimet (në punë, në komunikacion, apo gjetiu), për masat mbrojtëse, promovim dhe nxitja e sjelljeve të shëndosha ndaj jetës dhe mjedisit, etj.

IKSHP edhe ne vitin 2016, ka përcjellë dhe monitoruar situatën epidemiologjike me sëmundje ngjitëse dhe sëmundjeve tjera me origjinë ambientale. Ndotja e mjedisit shkaktonte një seri sëmundjesh tek njerëzit si; alergjitë e ndryshme, sëmundjet e lëkurës, diarre, sëmundjet respiratorë dhe sëmundje tjera.

Tabela 10. Sëmundjet ambientale dhe incidence e tyre gjatë viteve 2014-2016

Sëmundjet	2014		2015		2016		Trendi 2015-2016
	Rastet	Mbi 100000 banor	Rastet	Mbi 100000 banor	Raste	Mbi 100000 banor	
ITPR-Pneumonia/ARI	15242	839.4	12133	664	13897	760.5	↑
SARI (Formë e rënd e pneumonisë)	521	28.7	66	3.6	217	11.8	↓

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Influenca sezonale	39758	2189.7	41798	2287.5	84697	4635.2	↑
Diarreja akute	66196	3635.8	60361	3303.4	76386	4180.4	↑
Varicela	8651	476.4	7172	392.5	8075	441.9	↑
Sindromi i diarresë me gjak	38	2.1	22	1.2	29	1.5	↑
Sindroni meningjeal	188	10.3	250	13.6	152	8.3	↓
EHKK	5	0.2	1	0.05	1	0.05	↔
EHSV	14	0.7	2	0.1	4	0.2	↑
West Nile virus	4	0.2	2	0.1	0	0	↓
Sëmundja e lajmit	14	0.7	3	0.1	4	0.2	↑
Leishmaniasis	3	0.1	0	0	2	0.1	↑
Malaria	-	-	4	0.2	1	0.05	↓
Sindrome me ethe ekzantematike	21	1.1	23	1.2	14	0.9	↓
Pertussis	16	0.8	39	2.1	24	1.3	↓
Parotiti epidemik	3743	206.1	1900	103.9	184	10.06	↓
TBC	834	45.9	770	42.1	-	-	↓
Intoxicatio alimentaris	684	37.6	1202	65.7	2132	116.6	↑
Verdhëza akute A	154	8.5	124	6.7	124	6.7	↔
Verdhëza B	52	2.8	63	3.4	59	3.2	↓
Verdhëza C	14	0.7	12	0.6	21	1.1	↑
Verdhëza toxice	0	0	2	0.1	3	0.1	↔
Typhus abdominalis	6	0.3	3	0.1	11	0.6	↑
Sallmonelosis	53	2.9	81	4.4	66	3.6	↓
Rota virus	117	6.4	75	4.1	156	8.5	↑
Tularemia	105	5.8	378	20.6	27	1.4	↓
Lymphadenitis	92	5.1	192	10.5	106	5.8	↓
Leptospirosis	6	0.3	3	0.1	3	0.1	↔
Bruceleza	34	1.8	31	1.6	26	1.4	↓
Anthrax	6	0.3	-	-	-	-	-
Tetanus	0	0	2	0.1	1	0.05	↓
Echinococosis	0	0	4	0.2	-	-	↓
Toxoplasmosis	0	0	14	0.7	10	0.5	↓
Vulnus morsum viperi	9	0.5	13	0.7	45	2.4	↑
Vulnus morsum canis	-	-	-	-	1	0.05	↑
Sëmundjet tjera ngjitëse	752	33.8	592	32.3	539	29.4	↓
Total	137591	7578.2	127449	7374.5	187435	10257.8	↓

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Në dallim nga disa sëmundje, të cilat këtë vit raportohen në numër më të ulët, rastet e Influcencës sezonale raportohen në numër më të lartë gjatë vitit 2016. (tabela 10).

Zoonozat (brucelloza humane), raportohet në numër të ulët se sa në vitin 2015, ndërsa, tularemia raportohet për 14 herë në numër më të ultë, pasi që gjatë vitit 2015 u shfaq në formë epidemie.

Sa i përket rasteve të Variçelës, vërehet një rritje e numrit të rasteve nga 7172 në vitin 2015 në 8075 raste në vitin 2016. Sëmundjet të cilat raportohen në mënyrë të agreguar (grumbulluar), janë paraqitur 187435 raste ne krahasim me vitin 2015 qe ishin 127449 raste. Numri me i madh i këtij grupi të sëmundjeve i takon influenza sezonale me 84697, e përcjellë edhe sëmundja e Diarresë akute e cila raportohet me 76386 raste apo 4180.4/100000 banorë. Këto dy sëmundje qe kanë rezultuar me numër te madhe te pacienteve kanë origjinën nga higjiena e dobët dhe kushtet e dobëta socio-ekonomike, infrastrukturën jo të mirë për furnizim me uji të pijshëm nga burimet e pakontrolluara-puset, ndërprerja e gjatë e ujit nga ujësjellësi, mungesa e kanalizimit, prezenca e mbeturinave afër burimeve të ujit dhe ndotës tjerë nga aktivitet e ndryshme ekonomike.

Sa i përket rasteve të pneumonisë/ARI, edhe ne vitin 2016, ishte mjaftë e lartë me 13897 (mbi 760.5/100000 banorë), të cilat mund të jenë pasojë e paraqitjes se infeksioneve të sipërme respiratore por edhe mundësia që një pjesë e tyre janë raste me influence me komplikime si dhe ndotja e mjedisit.¹¹

Bazuar në rezultatet e monitorimit të kryer nga Qendra e Ujit e IKSHPK-së konform përgjegjësive që ka kjo Qendër për monitorim të jashtëm sipas UA Nr. 16/2012, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve ne **44 zona te furnizimit** (ZFU) të shtrira në zonat e shërbimit të shtatë KRU-të, është **99.2%** në përputhshmëri me vlerat parametrike mikrobiologjike, ndërkaq **98.0%** në përputhshmëri me vlerat parametrike kimike, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej **98.3%**. Kjo shkallë e përputhshmërisë është rezultat i **50,289 testeve** të kryera gjatë vitit 2016 nga gjashtë laboratorët rajonalë të QRSHP-të dhe Qendra e Laboratorëve Testues në IKSHPK. Rezultatet krahasuese për shtatë KRU-të janë paraqitur në grafikun më poshtë në Fig. 18.

¹¹ IKSHPK; Buletini vjetor i sëmundjeve infective, janar-dhjetor, 2016.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë




Figura 18: Shkalla e e përputhshmërisë me vlerat parametrike sipas KRU-ve dhe mesatarja në nivel të Kosovës¹².

Siç mund të shihet nga grafiku i mësipërm, përputhshmëria më e lartë sa i përket vlerave parametrike mikrobiologjike ka qenë në KRU Radoniqi 100% dhe KRU Prishtina 99.9%, ndërkaq përputhshmëria më e ulët në KRU Hidromorava 98% dhe KRU Hidroregjioni Jugor 98.3%.

Përputhshmëria më e lartë sa i përket parametrave kimik ka qenë në KRU Radoniqi me 100% përputhshmeri dhe KRU Mitrovica me 99.9%, ndërkaq KRU Hidrodrini me 97.0% dhe KRU Prishtina me 96.6% rezultojnë me përputhshmërinë më të ulët.

Krahasuar me vitin 2015, cilësia e ujit të pijshëm në vitin 2016 ka shënuar një përmirësim të theksuar. Kjo para së gjithash, e që është esencialisht e rëndësishme, vlen për cilësinë mikrobiologjike me përmirësim prej rreth 3% – nga 96.3 % në 99.2%. Në përgjithësi, shkalla e përputhshmërisë sa i përket parametrave mikrobiologjik dhe atyre kimik është përmirësuar nga 97.0% në 98.3%. Një pasqyrë e përmbledhur e rezultateve të monitorimit sipas zonave të furnizimit është dhënë në tabelën vijuese.

Tabela 11. Përformanca e përgjithshme e cilësisë së ujit të pijshëm publik në Kosovë sipas zonës së furnizimit për 2016¹³

¹² Raporti Vjetor i IKSHPK-së për Cilësinë e Ujit të Pijshëm për vitin 2016

¹³ Raporti Vjetor i IKSHPK-së për Cilësinë e Ujit të Pijshëm për vitin 2016

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Parametrat	Numri i testeve të kryera	Përputhshmëria me vlerat parametrike	Tejkalimi i vlerave parametrike	
		%	Nr.	Nr. i ZFU-ve
Koliformet totale	5,525	98.9	61	21
E coli	5,525	99.6	24	9
Klori rezidual	5,485	89.6	569	25
Turbullira	5,518	99.1	50	11
Era	2,026	100	0	0.0
Shija	2,026	100	0	0.0
pH	2,027	100	0	0.0
Nitratet	1,740	99.9	2	1
Nitritet	1,779	100	0	0.0
Hekuri	1,855	99.9	2	1
Mangan	1,726	99.9	2	1
Alumini	1,025	99.7	3	2
Parametrat tjerë	14,032	99.7	37	15
Totali:	50,289	98.5	750	35

Tabela 12: Krahasimi i rezultateve të përputhshmërisë 2015-2016

Parametri	Përputhshmëria në 2015: 35 ZFU			Përputhshmëria në 2016: 44 ZFU		
	Nr. i testeve	%	ZFU me tejkalim	Nr. i testeve	%	ZFU me tejkalim
Koliformet totale	5,003	95.4	19	5,525	98.9	21
E coli	4,991	97.2	16	5,525	99.6	9
Klori rezidual	4,904	89	24	5,485	89.6	25
Turbullira	4,799	99.2	8	5,518	99.1	11
Era	1,760	100	0	2,026	100.0	0
Shija	1,760	100	0	2,026	100.0	0
pH	1,760	100	0	2,027	100.0	0
Nitratet	1,258	92.1	9	1,740	99.9	1

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Nitritet	1,563	92.0	12	1,779	100.0	0
Hekuri	1,569	99.9	1	1,855	99.9	1
Mangan	1,306	99.0	10	1,726	99.9	1
Alumini	I përfshirë në "parametra të tjerë "me poshtë			1,025	99.7	2
Parametrat tjerë	12,692	99.3	19	14,023	99.7	15
Totali:	43,365	97.0		50,289	98.5	

Siç shihet nga tabela e mësipërme, rezultatet e monitorimit tregojnë se shkalla më e ulët sa i takon përputhshmërisë me vlerat parametrike ka të bëjë me klorin rezidual (89.6%) e që ka ndikuar në shkallën e përputhshmërisë me parametrat kimike. Kjo ndikon një problem operativ të cilin KRU-të duhet ta adresojnë në formën e duhur me klorim të rregullte dhe adekuat të ujit të cilin e furnizojnë. Parametrat tjerë kanë qenë përgjithësisht në nivel të kënaqshëm - mbi 99%¹⁴, përpos koliformeve totale që është afër 99%.

Sa i përket mbulueshmërisë me shërbimin e ujësjellësit, është shënuar rritje të lehtë nga 84% në 87% në vitin 2015 në raport me vitin 2014. Vetëm katër KRU kanë mbulueshmëri të pranueshme mbi mesataren e sektorit prej 87%.

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza në nivel sektori sikurse edhe tek shërbimi i furnizimit me ujë ka shënuar progres të lehtë për të arritur në nivelin 65% në vitin 2015. Janë shumica e KRU të cilat kanë mbulueshmëri me shërbime të kanalizimit rreth 50%, sidomos është brengosëse gjendja në KRU 'Hidrodrini' e cila vazhdon të këtë hapësirë të konsiderueshme për përmirësim.

KRU 'Prishtina' dhe 'Bifurkacioni', janë dy nga gjithsej shtatë KRU, me një nivel të pranueshëm të mbulimit me shërbime të kanalizimit, e para me mbi 89% dhe e dyta me 80%.¹⁵

¹⁴ Niveli i përputhshmërisë prej 99% e më shumë, nga Komisioni Europian konsiderohet si 'përputhshmëri e plotë'.

¹⁵ ARRU; Raporti vjetor i performances për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë në 2015.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Tabela 13: Të dhëna të përgjithshme për sistemet e ujësjellësit që menaxhohen nga ARRUK¹⁶

Treguesi	Nr.
Numri i Kompanive të Ujësjellësit	7
Numri i konsumatorëve	335,647
Numri i popullsisë së furnizuar (milion)	1.53
Sasia e ujit të furnizuar (milion m ³)	143.6
Gjatësia e rrjetit të ujësjellë (km)	4,620
Burimet sipërfaqësore të ujit	80%
Burimet nëntokësore të ujit	20%
Numri i zonave të furnizimit	44

Rekomandime:

- Të përmirësohet mjedisi urban duke u përpjekur për të zvogëluare ndikimet negative mjedisore,
- Të investohen edhe me shumë në zona të gjelbra në zonat urbane e cila do të jep shumë përfitime mjedisore, sociale dhe ekonomike.
- Të investohet në përmirësimin e kualitetit të ujit të pijes dhe monitorimin e rregullt të tij, përkundër progresit të arritur,
- Të bëhet rehabilitimi i zonave të ndotura në harmoni me një mjedis të pastër.
- Të respektohen kriteret e shkarkimeve të emisioneve ndotëse në ajër, ujë dhe tokë nga industria, transporti, bujqësia etj.
- Të bëhet monitorimi i të gjitha parametrave të paraparë me UA 16/2012 (pesticidet, benzeni, radioaktive etj.)
- Ngritja e kapaciteteve të KRU-ve për monitorim të ujërave të pijshëm.

¹⁶ Të dhënat i referohen vitit 2016 dhe janë ofruar nga ARRU.

4. Gjendja mjedisore në zonat e veprimit të operatorëve ndotës

4.1. Zona e veprimit e operatorit ekonomik KEK dhe ndikimi në mjedis

KEK-u në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore, raporton në mënyrë të rregullt çdo muaj dhe për secilin vit të kaluar dërgon raport vjetor për gjendjen e mjedisit. Raporti vjetor përmban të dhëna për bilancin material dhe energjetik, cilësinë e ajrit, emisionet në ajër, cilësinë e ujërave në zonën e operimit të KEK-ut, gjendja e mbeturinave, radioaktivitetit, zhurmës, vibracioneve, rikultivimit dhe të dhëna për projektet në përgjithësi. Objekt i këtij vlerësimi të gjendjes mjedisore pikërisht do jenë të dhënat nga raporti vjetor për vitin 2016 dhe raportet mujore, duke përzgjedhur disa nga karakteristikat, të cilat kanë ndikim më të madh në mjedis.

KEK-u prodhon rreth 97 (%) të sasisë së përgjithshme të energjisë elektrike në Kosovë, (energji e siguruar nga linjiti), kurse nga resurset ujore sigurohen vetëm rreth 3 (%) të energjisë elektrike.

KEK-u përbehet nga këto njësi : Minierat e Qymyrit (DPQ) dhe Gjenerimi me Termocentralin Kosova A (TCA) dhe Termocentrali Kosova B (TCB)¹⁷ dhe funksionon përmes divizioneve që ka në përbërje të vet:

- Divizioni për prodhimin e qymyrit (DPQ);
- Divizioni i TC Kosova A;
- Divizioni i TC Kosova B;
- Divizioni i Shërbimeve të Korporatës, në përbërje së cilës është Departamenti i Mjedisit dhe
- Njësitë tjera përcjellëse.

KEK-u në mënyrë të vazhdueshme përcjellë dhe analizon ndikimin e aktiviteteve të veta në mjedis.

Gjatë prodhimit të qymyrit në miniera sipërfaqësore dhe djegies së qymyrit në termocentrale kemi të bëjmë me gjermimin në shkallë të madhe të materialeve duke përdorur pajisje të rënda. Ky gjermim gjatë të cilit shfrytëzohen burimet minerare, shkakton ndikim të pashmangshme negative në mjedis, si :

- Sipërfaqe e gjerë e tokës e zënë nga miniera sipërfaqësore dhe depozitë e mbeturinave.
- Ndryshimi i florës dhe faunës në zonën përreth minierës për shkak të ndërtimit dhe aktiviteteve operative.
- Ndotja e mundshme tokës dhe ndotja e ujërave sipërfaqësor (depozitat e hirit, ujërat e minierave dhe të shkarkuara nga termocentralet).

¹⁷ Raporti i gjendjes mjedisore në KEK për vitin 2016, Departamenti për mjedis

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

- Humbja totale e habitateve ekzistuese në tokën e pushtuar. Ndryshimi i regjimit hidro-gjeologjik në një zonë të gjerë.
- Ndotja e ajrit nga pluhuri gjatë gjurmimit dhe transportit dhe emetimi pas djegies në Termocentrale.
- Procesi i vetëdjegëses së thëngjillit në sipërfaqe të mihjes sipërfaqësore.
- Ndikimet mbi stabilitetin e terrenit nga shpatet e pjerrëta dhe deformimi i sipërfaqeve (rrëshqitja e tokës).
- Zhurma nga pajisjet e minierës dhe aktiviteti i shiritave transportues, etj.

Disa të dhëna për ecuritë e prodhimit të energjisë elektrike gjatë viti 2016

- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga TC Kosova A për vitin 2016 ka qenë : 2 314 809 MWh.
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga TC Kosova B për vitin 2016 ka qenë : 3 933 959 MWh.
- Totali i prodhimit të energjisë elektrike si KEK: 6 248 768 MWh
- Harxhimi i përgjithshëm i linjtit për vitin 2016 nga termocentralet e KEK-ut: rreth 8 519 955 t
- Gjatë vitit 2016 TC Kosova A, mesatarisht ka shpenzuar rreth 1.52 t/MWh, ndërsa TC Kosova B rreth 1.26 t/MWh.
- Orët e punës: TC Kosova A3-4875 h; A4-6130 h; A5-5271 h dhe B1- 7141 h dhe B2-7279 h.
- Sasia e përgjithshme e hirit të prodhuar gjatë vitit 2016 për dy TC - të ka qenë rreth 1 060 728 t
- Konsumi i ujit në TCA dhe TCB ka qenë: 16 604 632 m³:
- Sasitë e shpenzuara të naftës dhe mazutit për vitin 2016: naftë në TC Kosova A - 2 248 608 litra dhe mazut në TC Kosova B- 2 628 800 litra.

Në Raportin e gjendjes mjedisore në KEK për vitin 2016 jepen edhe të dhëna për Vajrat e mbetura me përbërje të PBC (Bifenoleve të Polikloruara, vajrat mbeturinë, mbetjet radioaktive, azbestin, mbeturinat metalike dhe mbetjet tjera.

Vlerësimi i emisioneve në Termocentralet Kosova A dhe Kosova B për vitin 2016

Sipas Direktivës 2001/80/EC dhe UA nr.06/2007 të Qeverisë së Kosovës mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e pa lëvizshme të ndotjes me djegie të madhe janë prezantuar në tabelën vijuese.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Tabela 14: Normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e pa lëvizshme të ndotjes me djegie të madhe	
<i>SO₂</i>	400 mg/Nm ³
<i>NO_x</i>	500 mg/Nm ³
<i>Pluhur</i>	50 mg/Nm ³

Më poshtë janë paraqitur grafikisht emisionet e Pluhurit, SO₂ dhe NO_x në Termocentralet Kosova A dhe Kosova B gjatë muajve Janar - Dhjetor të vitit 2016.

Parametrat e SO₂, NO_x dhe CO₂ janë kalkuluar (përveç emisionit të pluhurit, i cili matet) në TCA , ndërsa në TCB janë të matura të gjithë parametrat.

Emisionet e Pluhurit në mg/Nm³ në TC A dhe TC B- Në figurën 19 shihet se emisionet e pluhurit në TC A nuk kanë pasur tejkalime gjatë muajve Janar - Dhjetor të vitit 2016, ndërsa në TC B gjatë kësaj periudhe vlerat janë shumë të larta.




Figura 19. Emisionet e pluhurit në mg/Nm³ gjatë muajve Janar - Dhjetor të vitit 2016

Emisionet e SO₂ në mg/Nm³ në TC A dhe TC B- Nga figura 20 shihet se tek TC A emisionet e SO₂ nuk kanë pasur tejkalime përveç muajit Prill dhe Nëntor shumë pak tejkalim, kurse në TC B shihet se gjatë muajve: Mars, Maj, Korrik, Gusht dhe Shtator ka pasur tejkalime.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë




Figura 20: Emisionet e SO₂ në mg/Nm³ gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2016

Emisionet e NO_x në mg/Nm³ në TC A dhe TC B- Në figurën 21, janë paraqitur emisionet e NO_x në TC A dhe në TC B, nga shihen tejkalime gjatë krejt muajve si në TC A po ashtu edhe në TC B.




Figura 21. Emisionet e NO_x në mg/Nm³ gjatë muajve Janar – Dhjetor të vitit 2016

Të dhënat për trendin e emisioneve ndotëse nga operatori ekonomik KEK janë prezantuar në shtojcën 3 të këtij raporti.

4.2. Zona e veprimit e operatorit ekonomik Feronikelit dhe ndikimi në mjedis

NeëCo Ferrinikeli Complex.LL.C, duke përmbushur obligimet ligjore për raportim të gjendjes mjedisore, raporton në bazë mujore dhe vjetore. Objekt i këtij vlerësimi të gjendjes mjedisore do jenë disa të dhëna nga Raporti vjetor 2016¹⁸ dhe raportet mujore.

Ferronikeli prodhon një ferroaliazh unik-ferronikelin (Fe-Ni). Metalurgjiku furnizohet nga minierat lokale (Gllavicë dhe Çikatovë si dhe xehe e importuar nga jashtë (Guatemala, Shqipëria etj.).

Procesi teknologjik është mjaft i gjatë dhe i komplikuar. Pas bluarjes, xehja dërgohet në furrën rrotulluese(janë dy furra të tilla) ku bëhet tharja dhe pjekja, duke përdor pet-koksin dhe mazutin si lëndë djegëse. Gazrat dhe pluhuri që lirohen në furrat rrotulluese trajtohen në precipitatorët elektrostatik. Xehja e pjekur përcillet në furrën elektrike ku bëhet shkrirja e saj në temperaturë 1400-1600°C.

Gazrat që lirohen nga furra elektrike trajtohen në sistemin për pastrim të gazrave (skruberë). Rafinimi i ferronikelit tani si lëndë e parë (13-16% Ni) realizohet në një konvertor vertikal (janë dy sish) duke fryrë oksigjen dhe me shtim të gëlqeres apo gurit gëlqeror. Rafinimi krijon skorien e konvertorit, e cila dërgohet në një impiant magnetik për ndarje (tash një thërrmues mobil). Gazrat që lirohen nga këtu trajtohen në skruber të lëngët (pastrim me ujë). Ndarja e feronikelit të rafinuar bëhet në formë granulash për arsye komerciale apo në formë kallëpesh-ingota 25 kg.

Ferro nikeli prodhon aliazhin Fe-Ni, që kryesisht përmban 25% Ni dhe 75 % Fe. Kapaciteti projektues i Ferro nikelit: 12 000 t Ni/Fe-Ni (25%Ni,75 %Fe). Me dy furra elektrike, prodhohen rreth 10 000 t Ni/Fe-Ni, gjatë një viti.

Lënda e parë, lëndët djegëse dhe lëndët ndihmëse që janë përdorur në Ferro nikel gjatë viti 2016:

Xehe: 399 749 t; linjit: 64 985 t; qymyrguri: 2 254 t; koks: 15 t; guri gëlqeror: 20 315 t; oksigjen i lëngët: 158 t; oksigjen i gaztë: 4300 t; energji elektrike : 209 170 MWh; mazut : 4 706 t; petkos: 1598 t; ujë teknologjik : 1 170 241 m³. etj.

Gjatë vitit 2016 janë prodhuar dhe deponuar në deponinë e skorjes në Sukë: 257 486 t skorje.

Feronikeli ka punuar në tre muajt e parë të viti 2016 dhe ka rifilluar në tetor të po këtij viti. Të dhëna mjedisore do prezantohen vetëm për 4 muaj sa ka raportuar Departamenti për mjedis i Feronikelit.

¹⁸ Raport vjetor-2016, Ferronikeli

Vlerësimi i emisioneve për vitin 2016

Feronikeli në tërë zinxhirin e tij prodhues, që nga nxjerrja e xehes, transporti, përgatitja, tharja, pjekja, deponimi, procesi i prodhimit të legurës hekur-nikel e deri te deponimi i mbetjeve industriale, paraqet një burim të rrezikshëm për mjedisin ku shtrihen pjesët e zinxhirit prodhues.

Përmbajtja e metaleve të rënda në xehen fillestare, si Fe, Ni, Co, Cd, Cr, As, Pb etj. dhe proceset metalurgjike që e shoqërojnë procesin e tërësishëm e karakterizojnë Ferro nikelin ndotës se kategorisë A (sipas Kriteve për VNM-BEZH dhe BB)



Pamje nga ferro nikeli dhe pikat e matjeve të emisioneve nga tymtarët

Vlerësimi i emisioneve për vitin 2016

Oxhaku i furrave rrotulluese- Te oxhaku i furrave rrotulluese janë paraqitur emisionet e pluhurit, SO₂ dhe NO_x. Në figurën 22 janë prezantuar emisionet e pluhurit te oxhaku i furrave rrotulluese gjatë vitit 2016. Sipas matjeve të emisioneve të pluhurit në këtë 4 muaj të pushimit nuk ka tejkallim të vlerave të emitimeve të pluhurit në ajër.

Ndërsa sa i përket emisioneve të SO₂ dhe të NO_x të shkarkuar nga oxhaku i furrave rrotulluese (figura 23 dhe figura 24) nuk ka tejkallime sipas vlerave të lejuar.

Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë




Figura 22. Emisionet e pluhurit te furrave rrotulluese gjatë të vitit 2016




Figura 23: Emisionet e SO₂ te oxhaku i furrave rrotuelluese gjatë vitit 2016




Figura 24: Emisionet e NOx te oxhaku i furrave rrotulluese gjatë katër muajve të vitit 2016

Emisionet te oxhaku i konvertorit - Te oxhaku i konvertorit janë paraqitur emisionet e Pluhurit, SO₂ dhe NO_x. Në figurën 25 janë prezantuar emisionet e pluhurit te oxhaku i konvertorit gjatë vitit 2016. Sipas matjeve te emisioneve te pluhurit gjatë vitit 2016 nuk ka tejkallim te vlerave te emitimeve te pluhurit ne ajër. Ndërsa sa i përket emisioneve të SO₂ dhe të NO_x të shkarkuar nga oxhaku i konvertorit (figura 26 dhe figura 27) janë regjistrua tejkallime minimale te vlerave të lejuara.




Figura 25: Emisionet e pluhurit te Oxhaku i konvertorit gjatë katër muajve të vitit 2016




Figura 26: Emisionet e SO₂ te oxhaku i konvertorit gjatë vitit 2016




Figura 27: Emisionet e NOx te oxhaku i konvertorit gjatë vitit 2016

Furra elektrike Nr.1 pas Skruberit- Te Furra elektrike nr.1 pas Skruberit është paraqitur vetëm emisioni i pluhurit, ku emisionet janë nën vlerat e lejuara sipas standardeve. (figura 28). Për parametrat tjerë nuk ka të dhëna.




Figura 28: Emisionet e pluhurit te Furra elektrike nr.1 pas Skruberit gjatë katër muajve të vitit 2016

Të dhënat për trendin e emisioneve ndotëse nga operatori ekonomik Feronikel janë prezantuar në shtojcën 3 të këtij raporti.

4.3. Zona e operatorit ekonomik SharCemit dhe ndikimi në mjedis

Treguesit kryesor për vitin 2016

Prodhimi i klinkerit: 415 062 t/vit

Prodhimi i çimentos : 711 883 t/vit

Vlerësimi i emisioneve për vitin 2016

Nga figurën 29 shihet se emisionet e pluhurit gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2016 kanë qenë me vlera shumë më të ulëta se vlera e lejuar. Kurse nga figura 30 dhe figura 31, shihet se emisionet e SO₂ dhe emisionet e NO_x gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016 kanë qenë me vlera shumë më të ulëta se vlera e lejuar.




